

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 21 datë 26 / 06 / 2025

“PËR PËRMIRËSIM TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË KOPSHTEVE TË BASHKISË KAVAJË”, “PËR KTHIMIN PJESËRISHT TË KOPSHTEVE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE GOLEM DHE LUZI VOGËL NË KOPSHTE ME USHQIM ”.

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë Neni 57, pika 1, ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH” i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, Ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2018, Urdhrit Nr. 31, datë 28.01.2020, “Për miratimin e Rregullores për Funkcionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”; Kreu II, “Arsimi Parashkollor”, Udhezimit nr.14 date 10.7.2023 “Per numrin e nxenesve per klase dhe ngarkesen mesimore te punonjesve arsimore”, VKB Nr. 68 datë 23.12.2024, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit të vitit 2025”, Kryetari Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e radhës, mori në shqyrtim dhe:

VENDOSI:

1. Në Arsimi Parashkollor dhe Shërbimet Mbështetëse të Arsimit Parashkollor, Parauniversitar dhe Qendrat Kulturore, hapjen e kopshteve me ushqim në Njësitë Administrative Golem dhe Luzi Vogël.
2. Në Arsimi Parashkollor dhe Shërbimet Mbështetëse të Arsimit Parashkollor, Parauniversitar dhe Qendrat Kulturore, shtohet numri i punonjësve me 11 (njëmbëdhjetë) duke përfshirë dy kuzhinierë, dy ndihmës kuzhinierë, tre edukatore, një pjatolarëse, një sanitare dhe dy roje, sipas lidhjes nr 2.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Burimeve Ekonomike dhe Arsimi Parashkollor.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.



Sekretari i Këshillit Bashkiak
MERI BITURKU

Miratuar me vota 24

Vota Pro 23

Vota Kunder —

Vota Abstenim 1

Zbardhur me datë 26/06/2025

KRYETAR
RUDIN HYLVIU

